



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 8
Prishtinë, më 24.4.2013, në orën 11.00
Ndërtesa e Kuvendit, sala S - 1

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Biserka Kostiq, Rita Hajzeraj - Beqaj, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Kimete Bytyçi, Kymete Bajraktari Justina Pula dhe Duda Balje.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Pjesëmarrës të tjerë: Lejla Selimi-OSBE; Agon Vrenezi-OHCHR; Raba Gjoshi-YIHR KS; Mehdi Mulaj-Kosova Press; Norë Shabani-Koha Ditore; Florije Kryeziu dhe Burim Tahiri- UNICEF.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25 mars 2013;
3. Diskutim lidhur me raportin vjetor të EULEX-it, që ka të bëjë me personat e zhdukur;
4. Njoftim rreth punës që është duke bërë grupi punues lidhur me aktivitetet për monitorimin e Ligjit për personat e zhdukur;
5. Shqyrtimi i peticioneve;
6. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 25. 3. 2013.

3 Diskutim lidhur me raportin vjetor të EULEX-it, që ka të bëjë me personat e zhdukur

Kryetarja – I njoftoi anëtarët e Komisionit se është fjala për raportin vjetor të aktiviteteve të Departamentit të Mjekësisë Ligjore të EULEX-it në Kosovë, ku kanë njoftuar për aktivitetet e ndërmarrura. Po ashtu, ajo theksoi se këtë raport e kanë marrë disa ditë më parë dhe kërkoi mendimin e anëtarëve të Komisionit, lidhur me raportin.

Rita Hajzeraj – Beqaj – Theksoi se është me rëndësi të dihet për vitin 2013, sepse thuhet se sa i përket personave të zhdukur, EULEX-i do t'ia bartë kompetencat Ministrisë së Drejtësisë. Ajo konsideroi se edhe deri më tani, Ministria e Drejtësisë, së bashku me Departamentin e Mjekësisë Ligjore, ka marrë pjesë në gjetjen dhe hulumtimin e trupave. Po ashtu, shfaqti dilemat se a do të barten të gjitha kompetencat nga EULEX-i tek Ministria e Drejtësisë apo vetëm marrja e detyrave për të hulumtuar në vendet e dyshuara. Ajo tha se është një paqartësi tek mënyra e bartjes së kompetencave nga EULEX-i tek Ministria e Drejtësisë dhe ishte e mendimit që të thirren në takim përfaqësuesit e EULEX-it, në mënyrë që të sqarohet kjo çështje.

Kymete Bajraktari – Shfaqti shqetësimet e saj lidhur me përmbajtjen e raportit. Ajo kishte vërejtje në disa pika të raportit, duke u fokusuar në kompletimin e listës, sepse lista ende nuk është e kompletuar. Ajo theksoi se për këtë gjë, disa herë ka kërkuar nga Komisioni Qeveritar që të bëjë kompletimin e kësaj liste. Ajo, po ashtu, kishte vërejtje edhe tek hipotezat e punës ku shprehimisht ceket se disa raste nuk i përkasin kohës së konfliktit dhe nuk precizohet se sa janë saktësisht ato raste. Ajo tha se këtij raporti i mungon edhe roundi tjetër, ku në vitin e kaluar EULEX-i e ka sjellë raportin me 300 persona të zhdukur, të cilët kanë qenë të djegur. Pra, këtij raporti i mungon sqarimi se çka ka ndodhur me mbetjet mortore të atyre 300 personave. Po ashtu, vërejtje kishte edhe në disa raste, ku thuhet se disa trupa u përkasin ushtarëve të huaj që asnjëherë nuk janë raportuar si të zhdukur, si dhe nuk ceket sa janë. Vërejtje kishte edhe në mungesën e sqarimeve dhe hulumtimeve tek rastet që dyshohet se i përkasin minoriteteve të tjera, si rom, ashkali dhe egjiptian. Ajo tha se ka paqartësi rreth përmbajtjes së tabelës, e cila i specifikon listat e përkohshme të personave të pagjetur dhe tha se për këtë është mirë të ftohen në takim përfaqësuesit e EULEX - it dhe të japin sqarime. Gjithashtu, ajo kishte

vërejtje edhe tek numri i varrezave, ku thuhet se në Kosovë janë mbi 20000 varreza, por me hulumtimet e arkivoleve që janë kryer nga EULEX - i ky numër është zvogëluar, por nuk e kanë saktësuar se sa është zvogëluar. Përveç këtyre vërejtjeve, ajo ishte e mendimit se në këtë vit EULEX - i e ka intensifikuar punën. Kjo vërehet edhe me gjetjen e trupave, mirëpo konsideroi se këtij raporti i mungojnë disa të dhëna, prandaj është mirë të thirren në takim.

Albana Gashi – Theksoi se raporti, përveç se është shumë i mangët, është edhe shumë i paqartë në disa pika, të cilat i ceku edhe parafolësja. Ajo tha se në këtë raport është e vështirë të dihet se cila punë është kryer, cila nuk është kryer. Po ashtu, ajo theksoi se të dhënat e njëjta iu janë dhënë edhe vitin e kaluar në takim me EULEX-in dhe Ministrinë e Drejtësisë. Sa i përket planeve të vitit 2013, ku thuhet se EULEX- i do të vazhdojë të kryejë veprimet që synojnë gjetjen dhe arritjen tek varrezat e pretenduara përtej kufijve të Kosovës, përkatësisht në lokacionin e Rashkës në Serbi, ajo shfaq shqetësimet e saj, sepse është e njëjta retorikë dhe çdo vit këto janë përsëritur, por hulumtimet nuk kanë ndodhur ende. Shqetësim tjetër janë varrezat në Mitrovicë, ku herën e fundit ata kanë deklaruar se kanë hulumtuar në ato varreza, por nuk kanë gjetur asgjë, ndërsa tani nga deklaratimet e tyre shihet se duke kërkuar në varrezat në Mitrovicë, kanë gjetur varreza masive. Sa i përket këtij rasti, kanë pasur ankesë edhe qytetarët e Mitrovicës se EULEX-i vetëm ka pretenduar se po punon diçka, por nuk ka arritur asgjë. Ajo e njoftoi Komisionin se shumë shpejt do të mbahet dëgjimi publik, lidhur me monitorimin e Ligjit për personat e pagjetur.

Kymete Bajraktari – Shfaq shqetësimet e saj lidhur me mospjesëmarrjen e Komisionit Qeveritar në rastin e zhvarrimit të mjetëve mortore në Mitrovicë. Ajo ishte e mendimit se këtë çështje duhet ta ngrenë, sepse edhe nëse është në Mitrovicën veriore, prapëse-prapë është në Kosovë.

Kryetarja – Sqaroi se më 9 prill, janë zhvarrosur 9 persona në Mitrovicë. Këtë shqetësim e kanë pasur edhe më herët qytetarët se pse nuk fillojnë mihjet në atë zonë dhe kanë qenë të irrituar me pretekstin e tyre për mungesë të sigurisë, por më vonë kanë marrë informacione se nuk ka pasur fare kërkesë në KFOR, që të ofrohet siguria në atë lokacion.

Biserka Kostiq – Theksoi se ky raport është mjaft konfuz dhe i paqartë. Ajo shprehu pakënaqësinë e mungesës së përfaqësuesve të EULEX- it, pasi që do të kishte mundësi të bënte pyetje për çështje të caktuara. Ajo tha se pajtohet me Rita Hajzeraj – Beqaj që ende nuk është koha që Ministria e Drejtësisë t'i marrë të gjitha kompetencat, pasi që ne e dimë mandatin e EULEX-it dhe ata duhet të veprojnë në bazë të mandatit të tyre. Ajo tha se ka disa vërejtje dhe për këtë do të dëshironte t'i pyeste përfaqësuesit e EULEX-it, të cilët nuk janë në takim lidhur me sfidat dhe pretendimet e lokacioneve kinse në Rashkë. Lidhur me këtë, ajo tha se nuk duhet të pretendohet, por të zgjerohet kërkimi në rajon. Sipas statistikave, Serbia ka bashkëpunuar dhe ka dhënë informata rreth lokacioneve. Ajo shfaq pakënaqësinë e saj lidhur me mungesën e përfaqësuesve të EULEX- it për të dhënë informata se a është mbyllur rasti i Zhilivodës, çka ka ndodhur me atë zjarr misterioz.

Gjithashtu, ajo shpreson se EULEX-i më në fund, do ta kuptojë rolin e vet, për të mirën e gjithë popullatës së Kosovës.

Kimete Bytyçi – Ishte e mendimit që EULEX-i të jetë prezent në takimin e radhës, në mënyrë që të sqarohen çështjet diskutabile. Sipas mendimit të saj, EULEX-i ka shkuar shumë ngadalë në veprimtarinë e tij dhe ky raport është i mangët.

Kryetarja – Theksoi se EULEX-i ka pasur mjaft aktivitete, mirëpo nëse nuk ka pasur rezultat në aktivitete, ajo është çështje tjetër, mirëpo nuk mund të konstatojmë se kanë munguar aktivitetet në këtë drejtim.

Kurtan Kajtazi – Ishte i pajtimit që të ftohen përfaqësuesit e EULEX-it dhe përfaqësuesit e mjekësisë ligjore në takim, sepse kanë nevojë për shumë sqarime lidhur me këtë raport.

Nga diskutimet lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, u konstatua se duhet të ftohen për takimin e radhës përfaqësuesit e Departamentit të Mjekësisë Ligjore, si dhe përfaqësuesit e EULEX-it.

4. Njoftim rreth punës që është duke bërë grupi punues lidhur me aktivitetet për monitorimin e Ligjit për personat e zhdukur

Albana Gashi – I njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me veprimet që janë ndërmarrë deri më tani. Ajo i informoi se është mbajtur një takim i grupit punues me karakter informativ, me qëllim të hartimit të planit, në bazë të cilit do të bëhet monitorimi i Ligjit për personat e zhdukur.

Biserka Kostiq – Shfaqti pajtimin për përfshirje në aktivitetet e grupit punues.

Kryetarja – Pasi që Rita tërhiqet nga grupi punues, atëherë Biserka do të jetë anëtare e këtij grupi.

5. Shqyrtimi i peticioneve

Rita Hajzeraj – Beqaj- E njoftoi Komisionin se janë tri peticione që janë shqyrtuar. Sa i përket peticionit të ish- punëtorëve të ndërmarrjes “Morava e Binqës”, ajo tha se ata kanë kërkuar shumën e caktuar në kuadër të 20 % që kanë pasur për të marrë nga privatizimi i kësaj ndërmarrjeje, mirëpo nuk i kanë marrë afërsisht 167 euro, që iu ka mbetur borxh Agjencia Kosovare e Privatizimit. Ajo shprehu mendimin për të thirrur anëtarët e AKP-së në takim, me qëllim të sqarimi se cilat janë taksat që janë paguar në emër të punëtorëve dhe pse nuk iu është dhënë ajo shumë e caktuar punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje.

Albana Gashi – Tha se përveç 20 %, ekzistojnë edhe mospagesat e pagave deri në 12 rroga që iu ka borxh kjo kompani. Ajo theksoi se raste të njëjta ka edhe në ndërmarrjet e

tjera, të cilat janë privatizuar. Ajo u pajtua me mendimin e Rita Hajzerajt – Beqaj, për thirrjen e përfaqësuesve të AKP- së në takim, në mënyrë që të sqarohet kjo çështje.

Rita Hajzeraj – Beqaj – Lidhur me peticionin e dytë, tha se e kanë shqyrtuar edhe më herët, në të cilin 82 kompani të naftës i kanë dhënë tri rekomandime për ligjin e naftës, i cili është në shqyrtim nga Komisioni për Tregti dhe Industri.

Lidhur me peticionin e parë, pas një debati të gjerë dhe konstruktiv, u vendos që të ftohen në takim përfaqësuesit e AKP-së, si dhe një përfaqësues i punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje.

Kryetarja – Ishte e mendimit që peticioni i dytë i naftarëve, të kalojë tek Komisioni për Zhvillim Ekonomik, pasi që është Komision funksional dhe do ta shqyrtojë këtë projektligj.

Kymete Bajraktari – Si Komision, është mirë që të dalim me një rekomandim, pasi që peticioni i është drejtuar Komisionit për të Drejtat e Njeriut.

Kryetarja – Tha se më vonë, lidhur me këtë projektligj, mund të paraqesin mendimet e tyre secili anëtar i Komisionit. Gjithashtu, mund t'i paraqesin me shkrim edhe propozimet e tyre për amendamente që të mund të përfshihen në këtë projektligj.

•
Rita Hajzeraj – Beqaj- Ishte e mendimit që si Komision, të dalin me propozime lidhur me këtë projektligj dhe të konstatohet se në këtë gjendje si është ky projektligj, i shkel të drejtat e njeriut.

Pas një debati të gjerë, lidhur me këtë peticion, u vendos që ky peticion t'i dërgohet Komisionit për Zhvillim Ekonomik, pasi që ky Komision do ta shqyrtojë këtë projektligj.

Kurtan Kajtazi – Lidhur me peticionin e tretë, e njoftoi Komisionin se është kërkesë e fshatit që përfaqësohet nga Këshilli i fshatit Stanovc i Poshtëm. Ai theksoi se banorët e këtij fshati kanë kërkuar që urgjentisht t'i merret leja e ndërtimit të këtij objekti, i cili quhet shtëpi pushuese, e cila, sipas mendimit të tyre, bie ndesh me normat e moralit. Ai theksoi se ka kontaktuar me Drejtorinë e Urbanizmit në Vushtrri, pasi që ata janë kompetent për dhënien e lejes së ndërtimit në këtë territor dhe ka marrë informacion se kjo çështje është mbyllur, sepse drejtoria e ka refuzuar projektin për këtë ndërtim. Mirëpo, më vonë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e ka anuluar këtë vendim, duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe për këtë arsye banorët e kanë nënshkruar peticionin, të cilin ia kanë dërguar edhe Komunës së Vushtrrisë dhe institucioneve të tjera. Në prill të viti 2013, Drejtoria e Urbanizmit të Komunës së Vushtrrisë sërisht ia ka refuzuar kërkesën për leje ndërtimi, pasi që kjo ngastër është tokë bujqësore dhe nuk mund të përdoret për qëllime të tjera, përveç në rastet me interes të veçantë.

Pas debatit, Komisioni vendosi që t'i njoftojë palët se e kanë shqyrtuar petitionin dhe janë në dijeni se ata kanë marrë përgjigje nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Vushtrrisë.

7. Të ndryshme

Kimete Bytyçi – Shfaq shqetësimet e saj lidhur me pengesat në realizimin e vizitave në terren, për shkak të mospërgjigjes së anëtarëve të grupit punues. Ajo tha se, në qoftë se nuk kanë mundësi të vijnë të gjithë anëtarët, atëherë vizita mund të realizohet me anëtarët e tjerë të grupit.

Kryetarja – Në qoftë se nuk i përgjigjen ftesës anëtarët e grupit, atëherë vizita të realizohet me ata anëtarë të cilët i janë përgjigjur njoftimit për vizitë. Po ashtu, ajo e njoftoi Komisionin se më 27 prill, për ndër të Ditës Kombëtare për Personat e Zhdukur, në Mejë të Gjakovës do të mbahet tubim përkujtimor. Ajo tha se do t'i njoftojë anëtarët në email lidhur me mënyrën e organizimit dhe kohën e nisjes për në Gjakovë, pasi që ajo ditë është e shtunë. Po ashtu, ajo i njoftoi anëtarët e Komisioni se lidhur me rekomandimet e fëmijëve që kanë dalë më 1 qershor 2012, duhet të mbahet një takim i veçantë për të analizuar situatën se sa janë marrë parasysh ato rekomandime nga ana e institucioneve që iu janë drejtuar këto rekomandime. Ajo tha se do të ftohen të gjitha institucionet përkatëse, të cilave iu janë dërguar këto rekomandime.

Kymete Bajraktari – Shfaq shqetësimin e saj lidhur me mosarritjen e raportit për trafikimin e qenieve njerëzore. Ajo tha se shumë herë e ka kërkuar këtë raport nga Ministria e Punëve të Brendshme, por ky raport ende nuk ka ardhur dhe ka kaluar mjaft kohë e gjatë. Ajo kërkoi informata se çka mund të ndërmarrë ajo, nëse edhe më tutje ky raport nuk arrin në Komision.

Kryetarja – E njoftoi se përmes pyetjeve parlamentare mund ta ngritë këtë çështje dhe të kërkojë direkt nga ministri informacione se pse nuk është dorëzuar ky raport në Komision.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali